

L I G J
Nr.8226, datë 29.7.1997

**PËR DHËNIEN E VOTËBESIMIT KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË KRYESUAR NGA
FATOS NANO**

Në mbështetje të nenit 33/4 dhe të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", pasi shqyrtoi programin dhe strukturën e Këshillit të ri të Ministrave të paraqitur nga Kryetari i Këshillit të Ministrave, Fatos Nano

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

I jepet votëbesimi Këshillit të Ministrave të kryesuar nga Fatos Nano, i ngarkuar me këtë detyrë, me dekretin nr.1837, datë 24.7.1997 të Presidentit të Republikës.

Neni 2

Miratohet programi i Këshillit të Ministrave, i paraqitur nga Kryetari i tij, Fatos Nano.

Neni 3

Miratohet struktura e Këshillit të Ministrave e përcaktuar me dekretin nr.1838, datë 25.7.1997, në përbërje të të cilit hyjnë edhe sekretarët e shtetit.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi më datën 29.7.1997.

Shpallur me dekretin nr.1863, datë 1.8.1997 të Presidentit të Republikës të Shqipërisë, Rexhep Meidani